

C.nr. 168/2012

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshfjen juridike te paditesve; dhe nga te cilet i perfaqson Avokat; nga sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurve; nga tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqson Perfaqsesi i perkohshem Avokat; nga sipas aktvendimit te kesaje gjykate dhe te paditurit nga Rr. " " p.nr, dhe te paditures; Komuna e te cilen e perfaqson Avokati Publik Komunal; baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e lendes se kontestit; 1.250,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.22.05.2014 jep kete;

AKTGJYKIM

I-APROVOHET kerkespadia e paditesve; dhe nga Mitrovica dhe **VERTETOHET** se paditesit ne baze te kontrates gojore te lidhur ne vit.1971 me gjyshin e te paditurit te dyte tani te ndjerin dhe te mbajtjes me mirbesim mbi 20 vite, jane bashkpronar me nga 1/2 te pjeses se parc. me kultur are e klasit te 1- ne vendin e qujtur " " , me siperfaqe prej **S=240m2** dhe **S=284m2** , me masa dhe kufi qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes e cila evidentohet ne emer te [A] 1/1, ZK- dhe pjeses se parc. kat. me kulturare ne vendin e qujtur " " , me siperfaqe prej **S= 58m2**, me masa dhe kufi qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes e cila evidentohet ne emer te Sula Sefedin 1/1 ZK- , si dhe pjeses se parceles me kultur ar e klasit te 1-ne vendin e qujtur " " me siperfaqe prej **S=2m2** me masa dhe kufi qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes e cila evidentohet ne emer te P.SH. Kuvendi Komunal- ZK-

II- DETYROHEN te paditurit qe te iu njohin kete te drejte paditesve dhe te lejojne qe paditesit kete palujtshmeri ta regjistrojne ne emer te tyre prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te proedures kontestimore



Paditesit ne padit e tyre te parashtruara si dhe nepernjet te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura kane theksuar se palujtshmerin kontestuese paditesit ne baze te kontrates gojore te lidhur ne vit 1971 me gjyshin e te paditurit te dyte, tani te ndjerin te kane bler me qmim prej 350.000 Dinar, te cilin qmim or tersi e kane paguar shitsit me rastin e marrjes ne posedim te kesaje palujtshmerie. Indesa mersi kane menduar se kjo marrveshje gojore iu majafton qe ata ne te ardhmen te jene pronar te palujtshmeris se siperekuar.

Paditesit menjeher pas blerjes te kesaje palujtshmerie te njejten e kane rrethekuar me anure ne te kane ndertuar 2 shtepi per banim e te cilin palujtshmeri e shfrytzojn pa pengesa nga askush gjermetani.

Paditesit tani vone kane kuptuar qe palujtshmeria e cila eshte ne posedim faktk te tyre qe nga blerja nuk evidentohet ne emer te tyre., andej kane interes juridik qe te evidentohen ne emer te tyre.

Pasi qe i padituri i dyte eshte ne adrese te panjohur i propozojne gjykates qe te njejtit te i caktoi perfaqsesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesve ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadive te paditesve ti aprovoi si te bazuara nga se paditesit kto palujtshmeri i kane fituar ne baze te shitblerjes gojore dhe mbajtjes me mirbesim mbi 20 vite.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesve e konform nen 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK, gjykata me aktvendimin C. nr.168/2012 dt. 01.04.2014 te paditurit i caktoj Perfaqsesin e perkohshem, Avokat nga i cili ne baze te ketije aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nen. 82.1.2 te LPK.

Gjykata seancen e shqyrtimit kryeor e mbajti ne mungese te pare dhe trete konform nen. 423.4 te LPK.

Perfaqsesi i perkohshem i te paditurit te dyte ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise se paditesve i propozoi gjykates qe te vendose ne baze te provave dhe te sjelle vendim meritor

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoj

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Certifikatat e pronesis njesia katastrale, nr. nr. ZK. te dt. 18.04.2014, Ekspertizen e ekspertit gjeodet, dt. 18.04.2014, Procesverbalin mbi kqyrje ne vend te kesaje gjykate dt. 16.04.2014, beri veshtirimin ne skicat e terrenit dhe kopjet e

planit dt 18.04.2014 kopjet e planit, Faturat e dt 18.06.2012 dhe 19.06.2012
Rajonal ne dt. 06.2013 si dhe ndegjoi deshmitaret; e
dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Certifikatat e pronesise te cekura me larte konstatohet se parc. kat. tani
lendore evidentohen ne emer te paditurve, sikurse qe eshte cekur ne dispozitiv te
aktgjykimit.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ;
pase matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te palujtshmerive nga ana e ekspertit
gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e
Gjeodezise dhe Katastrit ne , eshte vertetuar se palujtshmerite kontestuese
bine -gjegjesishte e perbejne parc. te cekura me larte me masa dhe kufij te shenura si ne
ekspertizen e dhene me shkrime dhe skicen e terenit te cilat jane pjese perberse te kesaje
ekspertize dhe te aprovur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga skica e terenit dhe kopja e planit te sipercekur, shifet shtrirja , perkufizimi
dhe siperfaqja e palujtshmerise tani lendore.

Nga Proqesverbali mbi kqyrjen ne vend i kesaje gjykate te sipercekure
konstatohet ; se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejt ne palujtsherin tani lendore gjendet
shtepia 1-katshe e rrethekuar me bloka betoni dhe dyer te metalta .

Ng faturat e sipercekura konstatohet se paditesit i jane ofruar
sherbime nga keto Kompani .

Deshmitari deklaroi; paditesit diku ne vit 1970-71 nga shitsi
tani i ndjer kane bler diku 5-6 ari truall ne te cilen ka qene 1-shtepi e vjeter, me
qmim prej 350.000Dinar. Ne tersi e kane paguar qmimin e shitblerjes dhe menjeher kane
hyre ne kete palujtshmeri te cilen e shfrytzojn nga shitblerja pa kurfar pengese..

Deshmitari deklaroi; paditesit para 30 viteve nga shitsi
kane bler diku 6 ari truall. Nuk ka qene prezent me rastin e shitblerjes dhe nuk e
din qmimin e shitblerjes. Ne at vend jane 2- shtepi dhe nga shitblerja e gjermetani
paditesit i shfrytzojne pa kurfar pengese nga askush. Ndersa shutesi ka vdekur
para dis viteve.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim
dhe konstatoi se Paditesit patundshmerin tani lendore e kane bler sipas marrveshjes
gojore nga shitesi , tani i ndjere me qmimte shitblerjes prej 350.000
Dinar, te cilin qmim ne tersi i kane paguar shitesit dhe menjeher kane hyre ne disponim
te lire dhe te papengushem te kesaj palujtshmerie qe nga shitblerja gjermetani.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr.
03/L-154, eshte percaktuar se: Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne
posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne te.



Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes paditesit e kane pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire keto palujtshmeri te tyre tani lendore dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesve ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i ketyre palujtshmerive.

Mbajtja me mirbesim ekziston se paditesit pjesen me te madhe te kesaj palujtshmerie tani lendore e kane blere nga pronari i saje qka vertetohet nga fleta poseduse ne emer te gjyshit te paditurit te dyte.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesit i kane bler keto palujtshmeri ne vit 1971 .

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes. paditesit kane hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem gjermetani te kesaje palujtshmerie.

Gjithashtu gjykata konstatoi se nuk ka prova se ndaje paditesve eshte zhvilluar ndonje procedure lidhur me palujtshmerit tani lendore nga ana e te paditurve

Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesve me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450 te LPK

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C.nr.168/2012 dt 22.05.2014..



Gjyqtari,
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves e permes kesaje gjykate.

Handwritten notes:
Dua - Juridikt.
T. do kalohet
mi aktgjykime = 20 E
27.05.2014

REPUBLIKA E KOSOVES | REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ESHTË I PLOTËFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
OSNOVNI SUD
MITROVICA

Me
Dana

23.06.2014
27.05.2014